



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9902,
DATË 17.04.2008 “PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE”, TË
NDRYSHUAR”**

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 17.07.2018, me cilësinë e **Komisionit për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar*”

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishin të pranishëm përfaqësues nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

1. Qëllimi i projektligjit

Qëllimi i këtij projektligji është fuqizimi i konsumatorëve nëpërmjet informimit të tyre për shitjet dhe shërbimet që ofrohen në treg, si dhe një mbrojtje për ato.

2. Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020

Projektligji “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar*” është i parashikuar në **Kapitullin 28: Mbrojtja E konsumatorit dhe shëndetit**”.

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Neni 70 i MSA-së njih rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “*Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European*”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;

- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përfaqësohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Pjesa e Tretë, “Politikat dhe veprimet e brendshme të Bashkimit Europian”, **Titulli I, “Tregu i brendshëm”, Neni 26** (ish-neni 14 TKE), **Titulli VII, Kreu 3 “Përafrimi i legjislacionit” Neni 114** (ish-neni 95 TKE), **Titulli XV “Mbrojtja e konsumatorit”, Neni 169** (ish-neni 153 TKE) pikat 1 dhe 2.
- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian: **Titulli IV “Solidariteti”, Neni 38 “Mbrojtja e konsumatorit”,**
- Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit BE - Shqipëri (MSA): **Titulli VI “Përafrimi i legjislacionit, zbatimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës”, Neni 76 “Mbrojtja e konsumatorit”.**

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- Direktiva 2011/83/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 Tetor 2011 “Mbi të drejtat e konsumatorit, e cila ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13/KEE dhe Direktivën 1999/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 85/577/KEE dhe Direktivën 97/7/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”, e ndryshuar.
- Direktiva 2013/11/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 Maj 2013 “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, e cila ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2006/2004 dhe Direktivën 2009/22/KE”, (Direktiva për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) konsumatore).

Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të *Acquis* të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

3. SHQYRTIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË DISPOZITAVE TË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS TË BE

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor e lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. **Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:**

[Type here]

“Ky ligj është përafruar **pjesërisht** me:

- Direktivën 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 Tetor 2011 “Mbi të drejtat e konsumatorit, e cila ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13/KEE dhe Direktivën 1999/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 85/577/KEE dhe Direktivën 97/7/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”, **e ndryshuar**. Numri CELEX 32011L0083, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.304, datë 22.11.2011, faqe 64 - 88.
- Direktivën 2013/11/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 Maj 2013 “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, e cila ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2006/2004 dhe Direktivës 2009/22/KE”, (Direktiva për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) konsumatore); numri CELEX: 32013L0011, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.165, datë 18.06.2013, fq.63-79.”

2. Pika 4 e nenit 2 të projektligjit që shton pikën 7.1 për të dhënë përkufizimin e termit “Mallra të bëra sipas specifikimeve të konsumatorit”, të riformulohet si vijon:

“7.1 “**Mallra të bëra sipas specifikimeve të konsumatorit**”, janë mallra të **paparafabrikuara**, të bëra në bazë të zgjedhjes personale apo vendimit të konsumatorit”.

3. Në nenin 19 të projektligjit që shton Nenin 52/3, pas shkronjës “c” të pikës 1 të shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) përpunimin e të dhënave personale, duke respektuar rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale të parashikuara në ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar””.

Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit, e miratoi atë me shumicë votash.

NËNKRYETARI

BLEDAR ÇUÇI